VENDIM
Nr. 249, datë 21.12.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ALB WIND ENERGY" SHPK, "PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 13, DATË 28.1.2008", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 5 dhe 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror"; pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7, të kushteve licencës nr. 53, seria NPM08, "Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike" (projekti "Visu" dhe projekti "Terpan"), të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/6 prot., datë 14.12.2020 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me kërkesën e shoqërisë "Alb Wind Energy" sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Shoqëria "Alb Wind Energy" sh.p.k. është licencuar nga ERE me vendimin nr. 13, datë 28.1.2008, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike për projektet VISU, me fuqi 140 mw, dhe projekti "Trepan", me fuqi 85 mw, me kushtet e tij respektive.

- Në vijim të këtij licencimi, ERE ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë për parkun eolik "Grykëderdhja e Shkumbinit Terpan", si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre me vendimet:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 13.9.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 139, datë 15.11.2013.

- Në vlerësim të sa më sipër, ERE, me vendimin nr. 89, datë 9.6.2016, "Mbi kërkesën e shoqërisë Alb Wind Energy sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licencës nr. 53, seria NPM08P, për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (projekti "Visu" dhe projekti "Terpan")", të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar", ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "Alb Wind Energy" sh.p.k., për zgjatjen e afatit të Ndërtimin, Instalimin, Shfrytëzimin të Centraleve Elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik "Projekti 'Visu' dhe projekti 'Terpan'".

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë "Alb Wind Energy" sh.p.k. nr. 53, seria NPM08P dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 13, datë 28.1.2008.

- Në vijim të shtyrjeve ndër vite, për shkak të kompleksit të problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen e plotë të studimit të fizibilitetit; të etapave administrative nëpër të cilat kalon projekti i parqeve eolike, si një teknologji e re për vendin; argumentet shpjeguese të dhëna dhe depozituara në ERE nga shoqëria, si dhe duke mbajtur në konsideratë qëndrimin e MIE-s me shkresën nr. 102/4 prot., datë 27.4.2015, i cili ka ardhur si përgjigje e shkresës së ERE-s nr. 14 prot., datë 7.1.2015, ku iu kërkua të prononcohet, lidhur me kompetencën institucionale të trajtimit të këtyre subjekteve në mbështetje të legjislacionit në fuqi, MEI bën me dije, se: VKM-ja nr. 1701, datë 17.12.2008, "Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese që nuk janë objekt koncesioni", nuk ka efekt prapaveprues. Vlerësimi i kërkesave lidhur me licencat e miratuara nga ERE duhet të bëhet konform dispozitave ligjore, të cilat kanë qenë në

fuqi në kohën e miratimit të këtyre licencave. Gjithashtu për këtë projekt, gjate kësaj kohe nuk ka pasur shprehje interesi nga palë të treta.

- Në vlerësim të sa më sipër, ERE, me vendimin nr. 5, datë 10.1.2018, "Mbi shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë "Alb Wind Energy" sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 49, seria NPM07P, "Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike", ka vendosur ndër të tjera:

Shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, "Për dhënien e licencës për ndërtim, instalim dhe shfrytëzim të centraleve elektrik me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale, shoqërisë "Alb Wind Energy" sh.p.k. për projektet 'Visu' dhe 'Terpan"', të ndryshuar, mbajtëse e licencës nr. 53, seria NPM08P, "Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike", deri në datën 15.11.2019.

- Në kuadër të afateve të vendosura në vendimin e sipërcituar, shoqëria "Alb Wind Energy" sh.p.k., me shkresën nr. 701 prot., datë 5.11.2019, ka kërkuar nga ERE shtyrjen me 48 muaj të afatit të plotësimit të kushteve të licencës, për të cilën Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 181, datë 20.11.2019, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Alb Wind Energy' sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar", vendosi ndër të tjera:

1. Të pezullojë shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Alb Wind Energy" sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike për projektet "Visu" dhe projektin "Terpan", deri në përfundimin e monitorimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

2. Të ushtrojë monitorim pranë subjektit "Alb Wind Energy" sh.p.k. për të evidentuar, për të dokumentuar e për të shqyrtuar të gjitha rrethanat të cilat aplikuesi pretendon se i kanë pamundësuar zbatimin e kushteve dhe afateve të parashikuara në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 13, datë 28.1.2008, "Për licencimin e shoqërisë 'Alb Wind Energy' sh.p.k., të ndryshuar", si dhe për të analizuar pasqyrat financiare të shoqërisë për të verifikuar shpenzimet e kryera deri më sot.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 143, datë 4.12.2020, u ngrit grupi i punës për monitorimin e kushteve të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar. Nga dokumentacioni i depozituar nga ana e shoqërisë dhe nga monitorimi i kryer konkludojmë ,se:

- Për sa i përket kushtit të vendosur në paragrafin e parë të pikës 1, të vendimit 13/2008, të ndryshuar, sigurimi i dokumenteve të pronësisë nga ana e shoqërisë është deklaruar se disponon të tilla, por për shkak të izolimit nga COVID-19 nuk ka staf në zyrë dhe si e tillë do t'i dërgojë ato në ERE në një kohë të dytë, pas përfundimit të pandemisë. Në lidhje me këtë dokumentacion, nga ana e shoqërisë nuk ka pasur asnjë reagim deri më sot dhe si e tillë ky kusht i vendimit mbetet ende i paplotësuar.

- Për sa i përket kushtit të vendosur në paragrafin e dytë të pikës 1, të vendimit nr. 13/2008, të ndryshuar, paraqitja e studimit të fizibilitetit, shoqëria ka bërë me dije se po përgatit një studim të ri fizibiliteti (i cili do të zëvendësojë atë që ka depozituar më parë në ERE), që do të mund të tregojë që ky projekt është i financueshëm dhe me efektivitet dhe beson se ky studim i ri do të përfundojë brenda 60 ditëve. Deri më sot nuk rezulton që nga ana e shoqërisë të jetë depozituar studimi i ri i fizibilitetit dhe si i tillë ky kusht i vendimit është ende i papërditësuar/plotësuar nga shoqëria.

- Sa i përket kushtit të vendosur në pikën 2, marrëveshja me OST-në, shoqëria nuk ka përcjellë në ERE marrëveshje për pikën e lidhjes me OST sh.a., por vetëm shprehje mendimi të OST sh.a. për pikën e lidhjes. Ajo që vihet re është, se OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 1182/1 prot., datë 18.2.2020, ka rikonfirmuar edhe njëherë mendimin e saj për mundësinë e lidhjes me rrjetin, duke i bërë me dije shoqërisë që të plotësoje dokumentacionin teknik të nevojshëm deri në nënshkrimin e

marrëveshjes sipas procedurave aktuale në fuqi. Në të tilla rrethana ky kusht i vendimit mbetet ende pa plotësuar nga shoqëria.

- Sipas deklarimeve të shoqërisë rezulton, se pjesën më të madhe të investimeve e ka realizuar në 2 vitet e para të licencimit (2008–2009) dhe se ato konsistojnë në instalimin e katër matësve për fuqinë e erës, në lartësinë 60 m dhe se njëkohësisht janë përgatitur të gjitha studimet lidhur me pajisjen me licencat e tjera përkatëse, si ajo e lidhjes me rrjetin elektrik, impaktit mjedisor (VNM). Sa deklarohet nga shoqëria nuk rezulton të jetë dokumentuar në ERE nëpërmjet dokumentacionit përkatës dhe vihet re se përgjatë periudhës në vijim e deri më sot, nuk është kryer ndonjë investim konkret për zhvillimin në terren të centralit me erë.

- ERE iu drejtua MIE-s me shkresën nr. 714 prot., datë 19.5.2020, "Mbi aplikimet për shtyrje afati të plotësimit të kushteve të licencave të lëshuara për parqet eolike", duke i bërë me dije se pranë Entit Rregullator të Energjisë janë depozituar kërkesat e shoqërive, të cilat janë licencuar nga ERE për ndërtimet e parqeve eolike në zona të ndryshme të vendit, për shtyrje të afatit të plotësimit të kushteve të vendimeve përkatëse të licencimit dhe i ka kërkuar informacion në lidhje me zonat ku aktualisht janë licencuar këto shoqëri, nëse janë paraqitur pranë MIE-s propozime apo shfaqje interesi nga subjekte të tjera.

- MIE, në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1, datë 13.7.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj: "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" dhe të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

- Në vijim të këtij komunikimi, ERE, me shkresën nr. 1071 prot., datë 28.8.2020, iu drejtua të gjithë të licencuarve për prodhim energjie elektrike nga parqet eolike, duke i bërë me dije qëndrimin e MIE-s dhe i ka kërkuar që brenda 10 ditëve nga marrja e kësaj shkrese të informohet në lidhje me ecurinë e plotësimit të kushteve respektive të licencimit.

- Shoqëria "Alb Wind Energy" sh.p.k. nuk ka kthyer përgjigje ndaj kësaj korrespondence.

- Siç rezulton nga konkluzionet e monitorimit, evidentojmë se shoqëria nuk ka bërë të gjitha përpjekjet që varen nga vullneti i saj për plotësimin e kushteve të vendimit të licencimit nr. 13, datë 28.1.2008, por vetëm ka deklaruar se ka hasur një sërë pengesash, të natyrës financiare dhe administrative, cilat kanë bërë të pamundur plotësimin në afat të kushteve të vendosura në vendimin nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar.

- Nisur nga vështirësitë e krijuara, për shkak të COVID-19 dhe masave të marra nga qeveria shqiptare për distancimin social, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19, monitorimi dhe finalizimi i praktikës ka pasur vështirësitë e veta për rakordimin, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 83, datë 4.5.2020, të Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "Alb Wind Energy" sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë "Alb Wind Energy" sh.p.k. nr. 53, seria NPM08P.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe MIE-n për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja dijeni, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti